

NJOFTIME FITUESI PËR PROCEDURA TË KUFIZUARA

BASHKIA LEZHË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR

Për:

1.

Operatorin Ekonomik “HYDRO-ENG CONSULTING” Shpk, me Nuis M11417503F dhe me
adrese Rruga “Deshmoret/4”, pasuria nr. 1/870, volumi 40, faqe 1, Zona Kadastrale 8514, Durrës,

2.

Operatorin Ekonomik “MIKI CONSULTING” Shpk, me Nuis K87628701K dhe me adrese Lagjja
“Vasil Shanto”, Rruga “Vaso Kadia”, godine nr. 1/506, Shkoder,

3.

Operatorin Ekonomik “NOVATECH STUDIO” Shpk, me Nuis L01717030C dhe me adrese Njesia
bashkiake nr. 8, rruga “Shenasi Dishnica”, nr. pasurie 10/221+1-18, zona kadastrale 8370, hyrja 1,
ap. 18, Tirane,

* * *

Procedura e prokurimit: Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit).

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-71160-12-04-2025.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Sherbimi i mbikqyerjes së punimeve me objekt: “Rindërtimi i
banesës kolektive (Pallati Nr. 71 demtuar nga Termeti), Bashkia Lezhe”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 Muaj nga data e nënshkrimit të Marreveshjes Kuader.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: X oferta ekonomikisht më e favorshme ☐ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë:

- 1- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Bersant Ylli” P/F, me Nuis L94017201S & “MAGNA
CHARTA” Shpk, me Nuis L92318021H,
- 2- Operatori Ekonomik “HYDRO-ENG CONSULTING” Shpk, me Nuis M11417503F,
- 3- Operatori Ekonomik “MIKI CONSULTING” Shpk, me Nuis K87628701K,
- 4- Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” Shpk, me Nuis L01717030C,

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Bersant Ylli” P/F, me Nuis L94017201S & “MAGNA
CHARTA” Shpk, me Nuis L92318021H,

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

I-Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Bersant Ylli” P/F, me Nuis L94017201S & “MAGNA
CHARTA” Shpk, me Nuis L92318021H,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE: Nuk ploteson piken 2.3.1 ku parashikohet se: *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ose

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

KVO verën se për të përmbushur këto kriter operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky BOE nuk ka paraqitur për asnjë nga anëtarët e BOE, dokumentacion në lidhje me kryerjen e shërbimeve të mëparshme të ngjashme.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur nën 76, pikë 3/a dhe nën 77, pikë 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar nën 92, pikë 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e BOE “Bersant Ylli” P/F, me Nuis

L94017201S & “MAGNA CHARTA” Shpk, me Nuis L92318021H, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Bersant Ylli” P/F, me Nuis L94017201S & “MAGNA CHARTA” Shpk, me Nuis L92318021H, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

- 1- Operatori Ekonomik “HYDRO-ENG CONSULTING” Shpk, me Nuis M11417503F,
- 2- Operatori Ekonomik “MIKI CONSULTING” Shpk, me Nuis K87628701K,
- 3- Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” Shpk, me Nuis L01717030C,

Shënim: Referuar VKM nr. 225, datë 12.04.2021 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, kualifikimi i ofertuesëve në fazën e parë, nuk është me pikë.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë zyres se protokolit te Bashkise Lezhe, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 18/12/2025

Ankesa: Nuk ka.